

PHILIPS

AC1715



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Siguria	2
	Fushat elektromagnetike (EMF)	4
	Riciklimi	4
	Deklarata EU e konformitetit, versioni i shkurtuar	4
2	Pastruesi i ajrit	5
	Përmbledhje e produktit	5
	Përmbledhje e komandave	6
3	Hapat e parë në fillim	7
	Instalimi i filtrit	7
	Funksionimi i treguesit të Wi-Fi	7
	Lidhja e energjisë elektrike	8
	Lidhja me Wi-Fi	8
4	Përdorimi i pastruesit të ajrit	9
	Kuptimi i dritës së cilësisë së ajrit	9
	Ndezja dhe fikja	10
	Ndryshimi i vendosjes së modalitetit	11
	Shkëmbimi i treguesve të ekranit	12
	Përdorimi i funksionit të ndezjes/fikjes së dritave	12
5	Pastrimi dhe mirëmbajtja	13
	Grafiku i pastrimit	13
	Pastrimi i trupit të pastruesit të ajrit	13
	Pastrimi i sensorit të grimcave	13
	Pastrimi i sipërfaqes së filtrit	14
	Ndërrimi i filtrit	15
	Resetimi i kohës së filtrit	17
6	Ruajtja	17
7	Zgjidhja e problemeve	18
8	Garancia dhe mbështetja	20
	Porositja e pjesëve ose aksesorëve	20

1 E rëndësishme

Siguria

Lexoni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Për të siguruar performancë optimale, sigurohuni që pastruesi të përditësohet në versionin e fundit. Këtë përditësim mund ta bëni përmes aplikacionit Air+.

Rrezik

- Mos e pastroni pajisjen me ujë, me ndonjë lëng apo detergjent tjetër (që merr flakë) dhe as mos lejoni futjen e tyre brenda pajisjes, në mënyrë që të shmangni goditjen elektrike dhe/ose ndonjë rrezik për zjarr.
- Mos spërkatni përreth pajisjes materiale që marrin flakë, të tilla si insekticidet apo parfumet.

Paralajmërim

- Përpara se ta lidhni pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", nga një pikë shërbimi e autorizuar nga "Philips" ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangni rreziqet
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore, apo që kanë mungesë përvoje dhe njohurish vetëm nëse ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhen kryer nga fëmijët pa qenë të mbikëqyrrur.
- Mos bllokoni vrimat e hyrjes dhe të daljes së ajrit, p.sh. duke vendosur objekte mbi vrimën e daljes së ajrit ose përballë vrimës së daljes së ajrit.

- Sigurohuni që objektet e huaja të mos bien brenda në pajisje nëpërmjet vrimave të daljes së ajrit.
- Ndërfaqja standarde WiFi e bazuar në 802.11b/g/n në 2,4 GHz me kapacitet maksimal prej 100 mW EIRP.
- Bluetooth versioni 5.0 (LE) në frekuencë 2,4 GHz me kapacitet RF nën 10 mW EIRP.

Kujdes

- Kjo pajisje nuk zëvendëson ajrimin e duhur, pastrimin e rregullt me fshesë me vakuum apo përdorimin e një aspiratori gatimi apo ventilatori gjatë gatimit.
- Gjithmonë vendoseni dhe përdoreni pajisjen mbi një sipërfaqe të thatë, të qëndrueshme, të niveluar dhe horizontale.
- Lini të paktën 20 cm hapësirë të lirë përreth pajisjes dhe të paktën 30 cm hapësirë të lirë mbi pajisje.
- Mos u ulni ose mos u mbështetni mbi pajisje. Mos vendosni asgjë mbi pajisje.
- Mos e vendosni pajisjen direkt poshtë një kondicioneri për të parandaluar kondensimin e tubave brenda në pajisje.
- Përdorni vetëm filtra origjinalë "Philips" të projektuar posaçërisht për këtë pajisje. Mos përdorni asnjë filtër tjetër.
- Djegia e filtrit mund të shkaktojë rrezik të paevitueshëm për njerëzit dhe/ose mund të rrezikojë jetën e tyre. Mos e përdorni filtrin si lëndë djegëse ose për ndonjë qëllim të ngjashëm.
- Shmangni përplasjet me pajisjen (në veçanti vrimën e hyrjes dhe të daljes së ajrit) me objekte të forta.
- Mos fusni kurrë gishtat apo objekte në vrimën e hyrjes dhe të daljes së ajrit, për të parandaluar lëndimin fizik ose problemet në funksionimin e pajisjes.
- Mos e përdorni pajisjen kur keni përdorur largues insektesh në formë tymi ose mos e përdorni në vende me mbetje vaji, tym djegieje ose me avuj kimikë.
- Mos e përdorni pajisjen pranë pajisjeve me gaz, pajisjeve ngrohëse ose oxhakëve të zjarrit.
- Hiqni gjithmonë spinën e pajisjes kur dëshironi që ta lëvizni, të pastroni pajisjen, të ndërroni filtrin apo kur doni të kryeni ndonjë mirëmbajtje tjetër.

- Kjo pajisje është parashikuar vetëm për përdorim familjar në kushte pune normale.
- Mos e përdorni pajisjen në ambiente të lagështa ose në ambiente me lagështi të lartë apo me temperatura të larta, si për shembull në banjë, tualet ose kuzhinë apo në një dhomë me ndryshime të mëdha temperature.
- Pajisja nuk largon monoksidin e karbonit (CO) ose radonin (Rn). Ajo nuk mund të përdoret si pajisje sigurie në rastin e aksidenteve me proceset e djegies dhe me kimikatet e rrezikshme.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Riciklimi

Ky simbol do të thotë që produkti nuk duhet të hidhet me mbeturinat normale të shtëpisë (2012/19/BE).



Ndiqui rregullat shtetërore për hedhjen e veçuar të produkteve elektrike dhe elektronike. Hedhja e duhur ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Deklarata EU e konformitetit, versioni i shkurtuar


Nëpërmjet këtij dokumenti, DAP B.V. deklaron se radiopajisja e llojit AC1715 është në përputhje me direktivën 2014/53/BE. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së gjendet në adresën e mëposhtme të internetit: **www.philips.com**.

2 Pastruesi i ajrit

Urime për blerjen dhe mirë se vini te Philips!


Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips", regjistroni produktin në faqen www.philips.com/welcome.

Përmbledhje e produktit



* Përdorni vetëm ushqyesin e dhënë me spinë

Përmbledhje e komandave



Butonat e komandimit

	Butoni i ndezjes/fikjes së dritave		Butoni i ndezjes/fikjes
	Butoni i ndërrimit të modalitetit		

Paneli i ekranit


	Treguesi i Wi-Fi		Modaliteti "Auto"
	Shpejtësia 1		Shpejtësia 2
	Modaliteti "Turbo"		Modaliteti "Sleep"
PM2.5	Ekrani PM2.5	IAI	Ekrani i indeksit të brendshëm të alergjenëve
	Sinjali për pastrimin e filtrit		Sinjali për ndërrimin e filtrit

3 Hapat e parë në fillim

Instalimi i filtrit

Hiqni të gjithë paketimit e filtrit përpara përdorimit të parë.

Shënim: Sigurohuni që ajërpastruesi të jetë hequr nga priza përpara instalimit të filtrit.



- 1 Tërhiqni kapakun e pasmë dhe hiqeni nga pajisja.
- 2 Nxirrni filtrin nga pajisja.
- 3 Hiqni të gjitha materialet e paketimit të filtrit të pastrimit të ajrit.
- 4 Vendoseni sërish filtrin në pajisje.
- 5 Rivendosni kapakun e pasmë.

Funksionimi i treguesit të Wi-Fi


Statusi i ikonës së Wi-Fi	Statusi i lidhjes së Wi-Fi
Pulson në ngjyrë portokalli	Duke u lidhur me smartfonin
I qëndrueshëm në portokalli	I lidhur me smartfonin
Pulson në ngjyrë të bardhë	Duke u lidhur me serverin
E qëndrueshme në ngjyrë të bardhë	I lidhur me serverin
Joaktiv	Funksioni Wi-Fi i çaktivizuar

Lidhja e energjisë elektrike

Shënim: Rrezik për goditje elektrike! Kur hiqni kordonin elektrik, gjithmonë hiqeni duke tërhequr spinën nga priza. Mos e tërhiqni kurrë kordonin.

Lidhni përshtatësin elektrik:

- Në fillim, në folenë elektrike në pajisje.
- Më pas, në prizën elektrike në mur.



Lidhja me Wi-Fi

Konfigurimi për herë të parë i lidhjes me Wi-Fi

- 1 Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin Philips "Air+" nga **App Store** ose **Google Play**.
- 2 Vendoseni spinën e ajërpastruesit në prizë dhe prekni  për të ndezur ajërpastruesin.
↳ Treguesi i Wi-Fi  pulson në portokalli për herë të parë.
- 3 Sigurohuni që smartfoni ose tableta juaj të jetë lidhur me sukses me rrjetin tuaj Wi-Fi.
- 4 Hapni aplikacionin "Air+" dhe klikoni te "**Connect a New Device**" ose shtypni butonin "+" në krye të ekranit. Ndiqni udhëzimet në ekran për të lidhur pastruesin e ajrit me rrjetin tuaj.



Shënim:

- Ky udhëzim vlen vetëm kur ajërpastruesi konfigurohet për herë të parë. Nëse rrjeti ka ndryshuar ose konfigurimi duhet kryer sërish, shih kapitullin "Rivendosja e lidhjes me Wi-Fi" në faqen 9.
- Nëse do të lidhësh më shumë se një ajërpastrues me smartfonin apo tabletë, duhet t'i bësh një nga një.
- Sigurohu që distanca mes smartfonit apo tabletës dhe ajërpastruesit të jetë më pak se 10 m pa ndonjë pengesë.

Rivendosja e lidhjes me Wi-Fi

Shënim:

- Rivendosni lidhjen Wi-Fi nëse ndryshoni rrjetin tuaj bazë.
- 1 Vendoseni spinën e ajërpastruesit në prizë dhe prekni  për të ndezur ajërpastruesin.
 - 2 Shtypni e mbani  për 3 sekonda derisa të dëgjoni një tingull bip.
 - ↳ Ajërpastruesi kalon në modalitet çiftimi.
 - ↳ Treguesi i Wi-Fi  pulson në portokalli.
 - 3 Ndiqui hapat 3-4 te seksioni **“Konfigurimi i lidhjes Wi-Fi për herë të parë”**.

4 Përdorimi i pastruesit të ajrit

Kuptimi i dritës së cilësisë së ajrit

Drita e cilësisë së ajrit ndizet automatikisht kur ndizet ajërpastruesi dhe ndriçon me të gjitha ngjyrat njëra pas tjetrës. Pas rreth 30 sekondash punë, sensori i grimcave zgjedh ngjyrën që përkon me cilësinë e ajrit përreth grimcave në ajër.

Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit përcaktohet sipas indeksit më të lartë midis matjeve PM2.5 dhe IAQ.

Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit	Niveli i cilësisë së ajrit
Blu	I mirë
Blu-e purpurt	I pranueshëm
E purpurt-e kuqe	I keq
E kuqe	Shumë i keq

PM2.5

Teknologjia e detektimit **AeraSense** detekton me saktësi dhe reagon shpejt edhe ndaj ndryshimeve më të vogla të grimcave në ajër. Ai ju ofron sigurinë e sinjalizimit PM2.5 në kohë reale.

Shumica e ndotësve të ajrit të brendshëm bie nën PM2.5 – që u referohet grimcave që barten në ajër më të vogla se 2,5 mikrometra. Burimet e zakonshme të ambienteve të mbyllur për grimca të imëta janë tymi i duhanit, gatimi, djegia e qirinjve. Disa baktere që barten nga ajri dhe sporet më të imëta të mykut, alergjenëve të kafshëve shtëpiake dhe grimcave alergjenëve të morrave të përfshihen gjithashtu nën PM2.5.

Niveli i PM2.5	Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit
≤12	Blu
13-35	Blu-e purpurt
36-55	E purpurt-e kuqe
>55	E kuqe

IAI

Sensori i nivelit profesional **AeraSense** detekton nivelin e alergjenëve të ajrit të brendshëm dhe me sinjalizim numerik nga 1 në 12, mund të shfaqet niveli i rrezikut të mundshëm për alergjenë të ajrit të brendshëm. 1 tregon cilësinë më të mirë të ajrit.

Niveli i IAI	Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit
1-3	Blu
4-6	Blu-e purpurt
7-9	E purpurt-e kuqe
10-12	E kuqe

Ndezja dhe fikja

Shënim:

- Për një performancë optimale në pastrim, mbyllni dyert dhe dritaret.
- Mbajini perdet larg hyrjes së ajrit apo daljes së ajrit.

- 1 Futni spinën e pastruesit të ajrit në prizën elektrike.
- 2 Shtypni  për të ndezur ajërpastruesin.
 - ➔ Ajërpastruesi tingëllon.
 - ➔ Në ekran shfaqet "----" gjatë nxehjes. Pas kësaj, ajërpastruesi tregon nivelin e PM2.5/IAI pas matjes së cilësisë së ajrit.
 - ➔ Ajërpastruesi punon në modalitetin automatik me IAI të shfaqur në ekran.



- 3 Prekni e mbani butonin  për 3 sekonda për ta fikur ajërpastruesin.

Shënim: Nëse ajërpastruesi qëndron i lidhur në prizë pasi FIKET, do të punojë me cilësimet e mëparshme kur të RINDIZET.

Ndryshimi i vendosjes së modalitetit

Mund të zgjidhni midis modaliteteve "Auto", "Speed 1", "Speed 2", "Turbo" ose "Sleep" duke shtypur butonin .



Modaliteti "Auto" (Ⓐ): Ajërpastruesi rregullon automatikisht shpejtësinë e ventilatorit në përputhje me cilësinë e ajrit të ambientit.



Shpejtësia manuale (↻ dhe ⌚):
Në modalitetin manual, ajërpastruesi funksionon me shpejtësinë 1 ose shpejtësinë 2.



Modaliteti "Turbo" (⌚): Ajërpastruesi funksionon me shpejtësi maksimale.




Modaliteti "Sleep" (☾): Ajërpastruesi funksionon qetë në një shpejtësi të ulët. Pas 3 sekondash, drita e ekranit fiket.


Shkëmbimi i treguesve të ekranit

Shënim: Pajisja shfaq si bazë nivelin PM2.5.

- Shtypni e mbani butonin  për 3 sekonda për të ndërruar treguesin e ekranit midis IAI /PM2.5.



Përdorimi i funksionit të ndezjes/fikjes së dritave



Me sensorin e dritës paneli i kontrollit mund të ndizet, fiket apo errësohet automatikisht në përputhje me dritën e ambientit. Drita e panelit të kontrollit do të jetë e fikur ose e errësuar nëse drita e ambientit është e errët. Ju mund të prekni një buton çfarëdo për të rindëzuar të gjitha dritat. Nëse nuk kryhet veprim tjetër, të gjitha dritat do të fiken ose do të zbehen përsëri për t'u përshtatur me dritën e ambientit.

Mund ta shtypni butonin  manualisht për të fikur të gjitha dritat dhe panelin e kontrollit. Shtypni cilindo buton për t'i aktivizuar të gjitha dritat.

5 Pastrimi dhe mirëmbajtja

Shënim:

- Hiqeni gjithmonë pajisjen nga priza përpara se ta pastroni.
- Mos e zhytni kurrë pajisjen në ujë apo në lëngje të tjera.
- Mos përdorni kurrë agentë pastrues gërryes, agresivë ose që marrin flakë, si për shembull klor apo alkool, për të pastruar pjesët e pajisjes.
- Mos përdorni kurrë lëngje (duke përfshirë ujin) për pastrimin e filtrit.
- Mos tentoni të pastroni sensorin e grimcave me fshesë me vakuum.

Grafiku i pastrimit

Shpeshtësia	Mënyra e pastrimit
Kur nevojitet	Fshini sipërfaqen plastike të pajisjes me një leckë të butë e të thatë
	Pastroni kapakun e vrimës së daljes së ajrit
Çdo dy muaj	Pastrojeni sensorin e grimcave me një tampon pambuku të thatë
☞ shfaqet në ekran.	Pastrojeni sipërfaqen e filtrit

Pastrimi i trupit të pastruesit të ajrit

Pastroni rregullisht pjesën e brendshme dhe të jashtme të pastruesit të ajrit për të parandaluar grumbullimin e pluhurit.

- Përdorni një leckë të butë e të thatë për pjesën brenda dhe jashtë ajërpastruesit dhe për vrimën e daljes së ajrit.

Pastrimi i sensorit të grimcave


Pastroni sensorin e grimcave çdo 2 muaj për funksionimin optimal të pajisjes.

Shënim:


- Nëse ajërpastruesi përdoret në ambient me pluhur, mund të duhet të pastrohet më shpesh.

- Nëse niveli i lagështisë në ambient është shumë i lartë, mund të zhvillohet kondensim te sensori i grimcave dhe cilësia e ajrit mund të tregojë një cilësi ajri më të ulët edhe kur cilësia e ajrit është në fakt e mirë. Nëse ndodh diçka e tillë, pastroni sensorin e grimcave.


2



3




5



- 1 Fikni pastruesin e ajrit dhe shkëputeni atë nga priza elektrike.
- 2 Hapni kapakun e sensorit të cilësisë së ajrit.
- 3 Pastroni sensorin e grimcave me një tampon pambuku të lagësht.
- 4 Thani mirë të gjitha pjesët me një tampon pambuku të thatë.
- 5 Mbyllni kapakun e sensorit të cilësisë së ajrit.

Pastrimi i sipërfaqes së filtrit



Statusi i dritës sinjalizuese të filtrit


Sinjalizimi i pastrimit të filtrit 𐀀 shfaqet në ekran.

Veprimi


Pastroni sipërfaqen e filtrit me një fshesë me korrent.

- 1 Fikni pastruesin e ajrit dhe shkëputeni atë nga priza elektrike.


2




3




4



5




6



- 2 Tërhiqni kapakun e pasmë dhe hiqeni nga pajisja.
- 3 Nxirrni filtrin nga pajisja.
- 4 Pastroni sipërfaqen e filtrit me një fshesë me korrent.
- 5 Vendoseni sërish filtrin në pajisje.

- 6 Rivendosni kapakun e pasmë.
- 7 Futni spinën e pastuesit të ajrit në prizën elektrike.
- 8 Shtypni butonin  për të ndezur pajisjen.
- 9 Shtypni e mbani butonin  dhe  për 3 sekonda për të resetuar kohën e ndërrimit të filtrit.
- 10 Lajini mirë duart pas pastrimit të filtrit.



Ndërrimi i filtrit

Kuptimi i kyçjes së mbrojtjes së shëndetshme


Ky ajërpastrues vjen i pajisur me një tregues ndërrimi filtri për t'u siguruar që filtri i ajërpastrimit të jetë në kushte optimale gjatë funksionimit të ajërpastruesit. Kur filtri duhet ndërruar, sinjali për ndërrimin e filtrit  ndizet në të kuqe.

Nëse filtri nuk ndërrohet në kohë, ajërpastruesi ndalon së punuari dhe kyçet automatikisht për të mbrojtur cilësinë e ajrit të ambientit. Ndërrojeni filtrin sa më shpejt të jetë e mundur.

Ndërrimi i filtrit


Shënim:

- Filtri nuk mund të lahet ose të përdoret përsëri.
- Fikeni gjithnjë ajërpastruesin dhe hiqeni nga priza përpara ndërrimit të filtrave.



Statusi i dritës sinjalizuese të filtrit	Veprimi
Ndizet sinjali i ndërrimit të filtrit 	Ndërrimi i filtrit NanoProtect (FY1700/30)

1 Fikni pastruesin e ajrit dhe shkëputeni atë nga priza elektrike.



2 Tërhiqni kapakun e pasmë dhe hiqeni nga pajisja.

3 Nxirrni filtrin nga pajisja.

4 Hiqni të gjitha materialet e paketimit të filtrit të ri.

5 Vendosni filtrin e ri në pajisje.

6 Rivendosni kapakun e pasmë.


7 Futni spinën e pastruesit të ajrit në prizën elektrike.

8 Shtypni butonin  për të ndezur pajisjen.

9 Shtypni e mbani butonin  dhe  për 3 sekonda për të resetuar shifrën e jetëgjatësisë së filtrit.

10 Lani duart mirë pas ndërrimit të filtrit.

Shënim: Mos i merrni erë filtrit, pasi ka mbledhur ndotës nga ajri.




Resetimi i kohës së filtrit

Filtrin mund ta ndërroni më përpara se të shfaqet në ekran sinjali për ndërrimin e filtrit (). Pas ndërrimit të filtrit ju duhet ta resetoni manualisht numëruesin e jetëgjatësisë së filtrit.

- 1 Mbajeni prekur butonin e energjisë  për 3 sekonda, për ta fikur pajisjen dhe hiqeni nga priza.

2



3



- 2 Futni spinën në prizë.
- 3 Brenda 15 sekondash pas ndezjes, shtypni e mbani butonin  dhe  për 3 sekonda për të resetuar shifrën e jetëgjatësisë së filtrit.

6 Ruajtja

- 1 Fikni pastruesin e ajrit dhe shkëputeni atë nga priza elektrike.
- 2 Pastroni ajërpastruesin, sensorin e grimcave dhe sipërfaqen e filtrit (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").
- 3 Lërinë të gjitha pjesët të thahen plotësisht në ajër përpara se ta vendosni në ruajtje.
- 4 Mbështillni filtrin me qese plastike hermetike ndaj ajrit.
- 5 Vendoseni pastruesin e ajrit dhe filtrin e tij në ruajtje në një vend të freskët dhe të thatë.
- 6 Lajini gjithmonë mirë duart pas veprimeve me filtrin.

7 Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në vendin tuaj.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Pajisja nuk punon më si duhet.	• Sinjali për ndërrimin e filtrit ka qenë i ndezur në vazhdimësi, por ju nuk e keni ndërruar filtrin përkatës. Si rezultat, pajisja tani është e bllokuar. Në këtë rast, ndërroni filtrin dhe shtypni gjatë  dhe  për të resetuar shifrën e jetëgjatësisë së filtrit.
Rryma e ajrit që del jashtë nga vrima e daljes së ajrit është dukshëm më e dobët sesa më parë.	• Sipërfaqja e filtrit është bërë pis. Pastroni sipërfaqen e filtrit (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").
Cilësia e ajrit nuk përmirësohet, edhe pse pajisja ka qenë në punë për një kohë të gjatë.	• Kontrolloni nëse keni hequr nga filtri materialin e paketimit. • Filtri nuk është vendosur në pajisje. Sigurohuni që filtri (FY1700/30) është montuar saktë. • Sensori i grimcave është i lagur. Niveli i lagështisë në dhomën tuaj është i lartë dhe shkakton kondensim. Sigurohuni që sensorin e grimcave të jetë i pastër dhe i thatë (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja"). • Dhoma është e madhe ose cilësia e ajrit jashtë është e keqe. Për një performancë optimale në pastrim, mbyllni dyert dhe dritaret gjatë kohës që përdorni pastruesin e ajrit. • Në ajrin brenda ka burime ndotëse. Për shembull tym duhani, tym gatimi, tym djegieje, parfum ose alkool. • Filtri po arrin fundin e jetëgjatësisë së përdorimit. Ndërroni filtrin me një filtër të ri.
Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit qëndron gjithmonë e njëjtë.	• Sensori i grimcave është bërë pis. Pastroni sensorin e grimcave (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Pajisja lëshon një aromë të çuditshme.	• Herët e para që përdorni pajisjen, ajo mund të lëshojë një aromë plastike. Kjo është normale. Megjithatë, nëse pajisja lëshon një aromë djegieje edhe nëse hiqni filtrat, atëherë kontaktoni me shitësin e "Philips" ose me një qendër shërbimi të autorizuar nga "Philips". Filtri mund të lëshojë aromë pasi është përdorur për një farë kohe, për shkak të thithjes së gazeve të ajrit të brendshëm. Rekomandohet që ta riaktivizoni filtrin duke e vendosur atë në dritën direkte të diellit për të vazhduar përdorimin e tij. Nëse aroma vazhdon akoma, ndërroni filtrin.
Pajisja bën shumë zhurmë.	• Është normale nëse pajisja punon në modalitetin "Turbo". • Në modalitetin "Auto", nëse pajisja bën shumë zhurmë, ka mundësi që pajisja të jetë duke punuar në shpejtësi të lartë, sepse cilësia e ajrit vjen duke u përkeqësuar ose cilësimi juaj personal në aplikacion nxit një shpejtësi të lartë të ventilatorit. Ju mund të zgjidhni modalitetin "Sleep" ose të ndryshoni cilësimet në aplikacion. • Nëse ka zhurmë jonormale, kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në vendin tuaj. • Nëse bie diçka brenda në vrimën e daljes së ajrit, ajo mund të shkaktojë nivel të lartë zhurme. Fikni menjëherë pajisjen, kthejeni atë përmbys për ta nxjerrë objektin jashtë pajisjes.
Pajisja tregon ende se duhet të ndërroj filtrin, ndërkohë që e kam ndërruar atë.	• Ndoshta nuk keni resetuar numëruesin e jetëgjatësisë së filtrit. Ndizni pajisjen. Më pas shtypni e mbani butonin  dhe  për 3 sekonda.
Në ekran shfaqet kod i gabimit "E1".	• Motori ka probleme funksionimi. Kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në vendin tuaj.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Konfigurimi i Wi-Fi nuk përfundoi me sukses.	- Nëse pastruesit të ajrit është i lidhur në rrugëzues me bandë të dyfishtë dhe aktualisht nuk është i lidhur në një rrjet 2,4GHz, atëherë kaloni në një bandë tjetër të të njëjtit rrugëzues (2,4GHz) dhe provoni përsëri që të lidhni pastruesin e ajrit. Rrjetet 5GHz nuk mbështeten. - Nuk mbështeten rrjetet e autentikimit nga interneti. - Kontrolloni nëse pastruesi i ajrit ndodhet brenda rrezes së rrugëzuesit Wi-Fi. Mund të provoni ta vendosni pastruesin e ajrit më pranë rrugëzuesit Wi-Fi. - Kontrolloni nëse është saktë emri i rrjetit. Emri i rrjetit bën dallim mes ë germave të mëdha e të vogla. - Kontrolloni nëse fjalëkalimi i Wi-Fi është i saktë. Fjalëkalimi është i ndjeshëm ndaj madhësisë së germave. - Riprovojeni konfigurimin me udhëzimet në seksionin "Rivendosja e lidhjes me Wi-Fi". - Lidhja me Wi-Fi mund të ndërpritet nga interferenca elektromagnetike apo natyre tjetër. Mbajeni pajisjen larg nga pajisjet e tjera elektrike që mund të shkaktojnë interferenca. - Kontrolloni nëse pajisja celulare është në modalitetin e avionit. Sigurohuni që të çaktivizoni modalitetin e avionit kur kryeni lidhje në një rrjet Wi-Fi. - Konsultohuni në seksionin e ndihmës së aplikacionit për këshilla më të plota dhe më të reja për zgjidhjen e problemeve.

8 Garancia dhe mbështetja

Versuni ofron një garanci dyvjeçare pas blerjes për këtë produkt. Kjo garanci nuk vlen nëse defekti ndodh për shkak përdorimi të gabuar apo mosmirëmbajtjeje. Garancia jonë nuk prek të drejtat tuaja sipas ligjit si konsumator. Për më shumë informacion ose për të përdorur garancinë, ju lutemi të vizitoni faqen tonë të internetit www.philips.com/support.

Porositja e pjesëve ose aksesorëve

Nëse ju duhet të ndërroni një pjesë ose nëse dëshironi të blini një pjesë shtesë, shkoni te shitësi i "Philips" ose vizitoni faqen e internetit www.philips.com/support.

Nëse keni probleme me blerjen e pjesëve kontaktoni me Qendrën e Kujdesit për Klientin të "Philips" në vendin tuaj.



Philips dhe emblema në formë mburoje e Philips janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren nën licencë.

Ky produkt është prodhuar dhe shitet me përgjegjësinë e Versuni Holding B.V., dhe Versuni Holding B.V. është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

2023 © Versuni Holding B.V.

AC1715_user manual_v1.0 (27/10/2023)

